



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 67 Prot

Tiranë, më 08.05.2009 2009

VENDIM Nr. 2 dt. 05.05.2009

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 05.05.2009, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara nga Këshilli Shkencor pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës

VENDOSI:

Sipas pikave të rendit të ditës:

1. **Miratohet:** Rregullorja e funksionimit të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve, sipas ndryshimeve të propozuara.

Miratohen projektet restaurimit të financuara nga buxheti i shtetit:

1. Preventivi i punimeve restauruese në prefekturën e Shkodrës. (Vazhdim punimesh).
2. Projekt restaurimi, konservimi, konsolidimi dhe mirëmbajtje e pamjes së jashtme arkitektonike të ansamblit të lagjes Mangalem, Berat. (e pjesshme)
3. Restaurim Kulla e Gjon Markagjonit, Shkodër. (U miratua projekti i ndërhyrjes për restaurimin e kullës dhe ndërtesës 2 katëshe ngjitur, me vlerën totale prej 11 milion lekësh, si dhe preventivi prej 5 milion lekësh për punimet restauruese për këtë vit, në kullë)
4. Restaurimi i kalasë së Peqinit. (**Miratohet me propozimin:** Pushteti lokal të marrë masat dhe të heqë paralelisht me investimin gjithë ndërtimet pa leje.)
5. Restaurim Kalaja e Beratit.
6. Projekti i restaurimit të kompleksit islamik në Xher-Mëhallë, Delvine. (**Miratohet me propozimin:** Të përgatitet studimi për përcaktimin e zonës së mbrojtur pa penguar zbatimin e projektit.

Lidhur me kërkesat e shqyrtimit të projekteve, të cilat financohen nga Bashkitë, ose institucione:

1. Ndërhyrjet në objektet e trashëgimisë kulturore dhe historike të qytetit të Himarës, Krujës dhe Tiranës. (Ju la si detyrë Këshillit Shkencor të IMK, brenda një periudhe shumë të shkurtër kohe, të përgatisë oponencën, lidhur me 3 projektet e propozuara).

2. Nuk miratohet: Projekt përshtatje, Dega Berat e Bankës së Mqipërisë, Ambienti i shërbimit, lagja Mangalem, Berat.
3. Projekti i rikonstruksionit të ish shkollës fillore në lagjen Kala. (Projekti miratohet në parim, por zbardhja e vendimit do të bëhet vetëm pas paraqitjes në KKR, të relacionit përfundimtar të hartuar nga grupi i punës, pas verifikimeve në terren).

Miratohen projektet e restaurimit të cilat presin financim:

1. Punime restauruese në Ujësjiellësin e Vranishtit.
2. Projekti i konservimit të muraturës dhe rrethimi me punime dhe në bazilikën e Shën Janit, Delvinë, Sarandë.
3. Konservimi dhe restaurimi i pikturës murale të kishës së Shën Kollit, Kala, Berat.
4. Projekt restaurimi i godinës ish shkolla 8-vjeçare “Jani Veveçka”, në lagjen kala, Berat.
5. Projekt kons. dhe rest. i pikturës murale të bemës në katedralen e Shën Mërisë – pjesë integrale e Muzeut “Onufri”, Berat.
6. Projekt restaurimi i ndërhyrjes konservuese dhe restauruese në Gimnazin (termat) pranë bazilikës C, Bylis.
7. Projekt restaurimi i fazës së parë në sterën publike Bylis.
8. Projekt restaurimi i murit perëndimor në vazhdim nga viti 2007, Bylis.
9. Ringritja e murit që ndan rrugicën e lagjes Goricë me oborrin e banesës së Z. Petraq Musha, Berat.
10. Restaurim e mirëmbajtje në qendrën historike Katedralja e Shën Mërisë së Fjetur (Sot muzeu Onufri), Berat.
11. Restaurim e mirëmbajtje në Q. Historike Konaket e qendrës mesjetare islamike, Berat.
12. Ambient shtesë sanitar në oborrin e perëndimor të katedrales së Shën Mërisë Fjetur (sot muzeu Onufri)

Do të diskutohen në mbledhjen e radhës projektet e restaurimit të cilat presin financim:

1. Projekt restaurimi i banesës së Dhimitër Ikonomit, lagja Goricë, Berat.
2. Projekti i restaurimit dhe rihabilitimit të kishës në Derven, Laç.
3. Projekt përshtatje, ish dyqani i luleve pranë xhamisë së Beqarit, Berat.
4. Projekt për konsolidime dhe restaurime në punishten e verës në katedralen e Bylisit.
5. Projekt i pastrimit dhe sistemimit i sterës antike në Bylis.
6. Projekt sistemimi i anës lindore të bastionit të murit rrethues në Bylis.
7. Projekt i resrtaurimit dhe rivendosjes në vend të pjesëve arkitektonike dhe në kompleksin peshkopal Bylis.
8. Projekti i pastrim sistemimit të murit jugor rrethues dhe murit jugor të stoas së teatrit në Bylis.

9. Projekti i për ringritjen e muzeit të shembur në afërsi të aeroportit dhe menazhimin e vejetacionit përreth tij. Butrint.
10. Konservimi dhe restaurimi i pikturës murale në kishën e Shën Mërisë, Apolloni.
11. Projekte konservimi Butrint 2009.

Miratohet kërkesa për licensë:

1. Kërkesë e shoqërisë "A.K.e R", për pajisjen me licensë të kategorisë C, "Punime restaurimi në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi", me drejtues teknik Gjergj Frashëri.

Nuk u diskutua kërkesa për licensë:

1. Kërkesë e arkitektes Lida Miraj, për pajisjen me licensë profesionale personale për kategorinë A, "Projektim e zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës".

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R
ARDIAN TURKU



SEKRETAR I KKR
PROF. DR. VALTER SHTYLLA

